

DOKUMENT POLITIKASH

Rovena Sulstarova

Jetnor Kasmi

RUAJTJA E ROJTARËVE: MBIKËQYRJA PARLAMENTARE E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA NË SHQIPËRI

Dhjetor 2020

Ky dokument u përgatit nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me mbështetjen e Fondacionit Hanns Seidel Shqipëri. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit.

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Institucionet e pavarura dhe marrëdhëniet e tyre me Parlamentin	6
Sfidat e mbikëqyrjes parlamentare	13
a. Përdorim i kufizuar i instrumenteve procedurale.....	13
b. Ndërveprim i kufizuar mes Parlamentit, ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura...	14
c. Angazhim jo proaktiv i Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.....	20
Përfundime dhe Rekomandime	21
Shtojcat	23
Shtojca 1. Pyetësor me deputetët dhe institucionet e pavarura (N=47).....	23
Shtojca 2. Pikat kryesore nga intervistat e thelluara me institucionet e pavarura.....	25
Shtojca 3. Lista e figurave	27
Shtojca 4. Pyetësori për deputetët	31
Shtojca 5. Pyetësori për institucionet e pavarura	36
Shtojca 6. Pyetje për institucionet e pavarura.....	40

Në një republikë parlamentare, si Shqipëria, pushteti u përket njerëzve. Mbikëqyrja parlamentare është një nga funksionet bazë të parlamentit. Përfaqësuesit e zgjedhur në parlament, nën funksionin mbikëqyrës të parlamentit, kontrollojnë pushtetin ekzekutiv dhe i kërkojnë llogari atij në emër të votuesve. Ky nocion është i natyrshëm në konceptin e ndarjes së pushteteve, i njohur si *trias politica*. Mbikëqyrja parlamentare mbetet pjesë e rëndësishme e sistemit të kontrollit dhe balancave për të siguruar që askush të mos ketë pushtet absolut në një demokraci.¹

Po ashtu, Parlamenti mbikëqyr edhe institucionet e pavarura dhe është përgjegjës për miratimin e mandatit, buxhetit dhe për funksionimin e tyre. Institucionet e pavarura janë institucione shtetërore të krijuara me kushtetutë, si Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Avokati i Popullit, ose janë të krijuara me ligje të veçanta të miratuara nga Parlamenti, si Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP) dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD). Institucionet e pavarura në përmbushje të mandatit të tyre nxjerrin rekomandime për përmirësimin e funksioneve të ekzekutivit dhe për mbrojtjen e interesit publik. Megjithatë, atyre u mungojnë kompetencat për të detyruar zbatimin e tyre. Prandaj, është roli i parlamentit, i cili vëzhgon si institucionet ekzekutive ashtu edhe ato të pavarura, për të siguruar që të zbatohen rekomandimet e dhëna.

Kjo çështje u ngrit edhe nga Komisioni Evropian në kuadrin e reformave që i kërkohe Shqipërisë në drejtim të përmirësimit të qeverisjes dhe llogaridhënies publike të ekzekutivit në vend.² Në vitin 2017, në zbatim të rekomandimit të Komisionit Evropian, Parlamenti i Shqipërisë krijoi mekanizimin ndërinstitucional për monitorimin sistematik të ecurisë dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Ky mekanizëm i përbashkët ka në përbërje parlamentin, qeverinë, dhe vetë institucionet e pavarura.³ Pavarësisht këtij zhvillimi, Raporti i

¹ Unioni Ndërparlamentar (2017), "Mbikëqyrja parlamentare: Pushteti i Parlamentit për t'i kërkuar llogari qeverisë" Gjenevë, Zvicër, aksesuar për herë të fundit në 1 mars 2021: <https://www.ipu.org/resources/publications/reports/2017-10/global-parliamentary-report-2017-parliamentary-oversight-parliaments-power-hold-government-account>

² Komisioni Evropian (2019), "Raporti për Shqipërinë 2019", Dokument Pune i Stafit të Komisionit, Bruksel, f. 8, aksesuar më 7 prill 2020, në adresën <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>; <file:///C:/Users/Perdorues/Desktop/Raporti%20p%C3%ABr%20Shqip%C3%ABrin%C3%AB%202020.pdf>

³ Vendimi Nr. 49/2017 i Kuvendit të Shqipërisë "Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese"

Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019 nxori në pah se zbatimi i rekomandimeve të institucioneve të pavarura është i ulët. Për më tepër, sipas Komunikatës 2019 për Politikën e Zgjerimit të BE-së, e drejta e qytetarëve shqiptarë për një administratë të mirë është kufizuar nga dështimi i vazhdueshëm i institucioneve publike në vend për zbatimin e rekomandimeve të organeve mbikëqyrëse.⁴

Në këtë dokument, argumentojmë se Parlamenti i Shqipërisë, në cilësinë e tij si mbikëqyrës i ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura, duhet të luajë një rol më aktiv duke i ushtuar presion ekzekutivit për t'iu përgjigjur rekomandimeve të nxjerra nga institucionet e pavarura që kontribuojnë në qeverisjen e mirë dhe mbrojtjen e interesit publik. Për të shqyrtuar me imtësi marrëdhëniet mes Parlamentit dhe institucioneve të pavarura do të ishte e dobishme që fillimisht të bëhej dallimi mes (1) zbatimit të rekomandimeve të nxjerra nga institucionet e pavarura për ekzekutivin; dhe (2) zbatimit të rekomandimeve të nxjerra nga Parlamenti për institucionet e pavarura. Hulumtimi ynë përfshin kryesisht periudhën pas krijimit të mekanizmit të përbashkët ndërinstitucional dhe përqendrohet në një kampion prej katër nga 21 institucione të pavarura në Shqipëri.

Institucionet e zgjedhura janë Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP) dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD). U zgjodhën këto institucione të pavarura, sepse ato mbulojnë fusha të rëndësishme me interes publik, si menaxhimi i financave publike dhe të drejtat e njeriut. Këto institucione janë edhe nga më të konsoliduarat dhe më pranë publikut, duke qenë se rekomandimet apo raportet e tyre shpesh i komunikohen publikut nëpërmjet medias.

Metodologjia e përdorur për analizën mbështetet në instrumente cilësore dhe sasiore. Analiza u mbështet nga një shqyrtim i plotë i dokumenteve ligjore, dokumenteve kryesore strategjike, raporteve dhe dokumenteve administrative të bëra publike nga institucionet e pavarura, Parlamenti, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Shqyrtimi i literaturës dhe dokumenteve kryesore çoi në identifikimin e çështjeve ligjore dhe administrative që ndikojnë në efektivitetin e mbikëqyrjes parlamentare, të cilat u shqyrtuan më tej duke mbledhur statistika administrative.

U mblodhën dhe u analizuan të dhëna administrative dhe parësore për të evidentuar se si ndikon mbikëqyrja parlamentare tek efektiviteti i institucioneve të pavarura gjatë

⁴ Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit Evropian: Raporti për Shqipërinë 2019, aksesuar për herë të fundit më 18 mars 2020.

kërkesës së llogarisë ndaj ekzekutivit. Për të matur efektivitetin kemi analizuar të dhënat administrative në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të nxjerra nga institucionet e pavarura për ekzekutivin dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të hartuara nga Parlamenti për institucionet e pavarura. Të dhënat administrative janë nxjerrë nga raportet vjetore të institucioneve të pavarura dhe platforma ndër-institucionale online e monitorimit parlamentar.

Për të kuptuar procesin e mbikëqyrjes parlamentare dhe efektivitetin e tij, u mbledhën të dhëna parësore nëpërmjet anketimit me deputetë dhe përfaqësues të institucioneve të pavarura. Kampioni i sondazhit u bazua në vetë-identifikimin dhe reagimin e popullatës, e cila përbëhet nga deputetë të Parlamentit dhe përfaqësues të nivelit të lartë të institucioneve të pavarura.

Sondazhi u zbatua përmes një platforme online dhe iu dërgua çdo anëtar të popullatës së anketuar, që do të thotë të gjithë deputetëve të Parlamentit dhe personelit drejtues të institucioneve të pavarura të përfshirë në këtë studim. Kështu, sondazhi iu shpërnda 140 deputetëve dhe 70 punonjësve të institucioneve të pavarura. Përqindja e përgjigjes në këtë sondazh ishte 15% me 52 pyetësorë të plotësuar, 24 pyetësorë u plotësuan nga deputetët dhe 28 pyetësorë u plotësuan nga institucionet e pavarura. Sipas madhësisë së kampionit dhe duke përdorur një marzh besimi prej 95%, gabimi i matjes për rezultatet e raportuara është +/- 2,8%. U përdorën analizat e studimit për të shpjeguar gjetjet nga të dhënat administrative për zbatimin e rekomandimeve të Parlamentit apo të institucioneve të pavarura.

Së fundi, u përdor edhe një instrument me intervista të thelluara si instrument metodologjik për të vleftësuar gjetjet nga shqyrtimi i dokumenteve kryesore, i të dhënave administrative dhe i informacionit të sondazhit me përfaqësuesit e institucioneve të pavarura dhe të Parlamentit. Në total u realizuan shtatë intervista të thelluara nga autorët gjatë periudhës shtator-tetor 2020.

Analiza dhe rekomandimet në këtë dokument mund të shërbejnë si bazë për përmirësimin e funksionit të mbikëqyrjes parlamentare dhe të marrëdhënieve të Parlamentit me institucionet e pavarura. Dokumenti është i strukturuar në dy pjesë. Pjesa e parë ofron një pamje të përgjithshme të marrëdhënieve mes institucioneve të pavarura dhe Parlamentit. Në pjesën e dytë, bëhet një analizë e sfidave për një mbikëqyrje efektive parlamentare mbi institucionet e pavarura. Në fund të dokumentit jepen përfundimet dhe rekomandimet.

INSTITUCIONET E PAVARURA DHE MARRËDHËNIET E TYRE ME PARLAMENTIN

Institucionet e pavarura janë pjesë përbërëse e kontrollit dhe ekuilibrave të çdo demokracie kushtetuese dhe të një qeverie të përgjegjshme. Për të qenë plotësisht të pavarur, ato duhet të jenë jashtë ndikimit të institucioneve të tjera publike ose private. Kështu, ato duhet të kenë pavarësi në veprimtarinë e tyre. Në mënyrë të veçantë, për të përmbushur detyrat e tyre të ngarkuara nga ligji dhe për të kontribuar në mënyrë efektive në ruajtjen e mbikëqyrjes së pavarur, këto institucione duhet të jenë të pavarura nga ekzekutivi.⁵ Gjithsesi, me gjithë pavarësinë e tyre, këto institucione nuk janë mbi ligjin dhe duhet të japin llogari.⁶ Kjo detyrë i takon Parlamentit, i cili mbikëqyr dhe monitoron punën e tyre. Raportet e institucioneve të pavarura që i paraqiten Parlamentit duhet të shqyrtohen nga komisionet përkatëse parlamentare dhe në seancë plenare.⁷ Në këtë mënyrë, pushteti i institucioneve të pavarura, ashtu si edhe i çdo institucioni tjetër demokratik, mbahet nën kontroll.

Në varësi të funksioneve të tyre, institucionet e pavarura mund të grupohen në dy kategori. E para përfshin institucionet që mbikëqyrin respektimin e qeverisjes së mirë dhe të standardeve të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve të ndryshme publike në vend. Kategoria e dytë bën së bashku agjencitë dhe institucionet që kryejnë funksione këshillimore, rregullatore dhe funksione të tjera si për qeverinë, Parlamentin apo organet e pushtetit gjyqësor ashtu edhe për aktorët joqeveritarë (si bizneset, ndërmarrjet apo mediat). Funksioni i mbikëqyrjes i atribuohet kryesisht Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), i cili mbikëqyr përgjithësisht çështjet financiare. KLSH është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në Shqipëri. Institucione të tjera të pavarura të analizuar në këtë dokument janë:

- Avokati i Popullit, që shqyrton veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj;

⁵ Bulmer, Elliot (2019) "Independent Regulatory and Oversight (Fourth-Branch) Institutions." doi:10.31752/idea.2019.27, aksesuar për herë të fundit më 7 maj 2020 në adresën: <https://www.idea.int/sites/default/files/publications/independent-regulatory-and-oversight-institutions.pdf>

⁶ De Vrieze, F. (2019) "Independent oversight institutions and regulatory agencies, and their relationship to parliament: Outline of the assessment framework." Aksesuar për herë të fundit më 20 mars 2020. https://www.efd.org/wpcontent/uploads/2019/02/WEB_INDEPENDENT-OVERSIGHT-INS.pdf

⁷ Neni 103 i rregullores së Procedurës së Kuvendit <https://shtetiweb.org/wpcontent/uploads/2013/06/Rregullorja-e-Kuvendit.pdf>

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili kontrollon aksesin në informacionin publik dhe dokumente, objekt ankimi, sipas ligjit për të drejtën e informimit apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara “sekret shtetëror”. Ai kryen edhe hetime administrativ dhe ka të drejtën e aksesit në përpunimin e të dhënave personale si edhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm në përmbushje të detyrimeve të tij mbikëqyrëse;
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), që është autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi, si dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Këto institucione të pavarura janë krijuar, ndër arsyt e tjera, për të ndihmuar në funksionin mbikëqyrës së Parlamentit. Institucionet e pavarura kontrollojnë punën e ekzekutivit dhe të administratës publike përmes një stafi të specializuar që ka një mandat të qartë për një fushë të caktuar. Duke vepruar kështu, institucionet e pavarura kontribuojnë dhe forcojnë funksionin e mbikëqyrjes së Parlamentit dhe së bashku me këtë të fundit veprojnë si vëzhgues të qeverisë dhe institucioneve të tjera publike.


Marrëdhënia mes parlamentit dhe institucioneve të pavarura të mbikëqyrjes rregullohet kryesisht nga ligjet kushtetuese që rregullojnë funksionimin e institucioneve të caktuara të pavarura dhe nga Rregullorja e Parlamentit. Sipas legjislacionit në fuqi, Parlamenti ndërvepron me institucionet e pavarura në funksionin e tij të mbikëqyrjes në të paktën katër mënyra të ndryshme: i) përcaktimi i mandatit dhe i përgjegjësisë të institucioneve; ii) monitorimi dhe raportimi për aktivitetin vjetor të institucioneve, përfshirë ndjekjen e rekomandimeve nga parlamenti; iii) emërimi i bordeve drejtuese dhe drejtuesve të institucioneve përkatëse dhe iv) miratimi i buxhetit të institucioneve.

Në sondazh, deputetëve dhe përfaqësuesve të institucioneve të pavarura iu kërkua të raportojnë se në cilat aktivitete të mbikëqyrjes parlamentare janë angazhuar ata. Deputetët deklaruan se pjesëmarrja gjatë raportimit vjetor të institucioneve të pavarura është instrumenti më i zakonshëm për t’u angazhuar në mbikëqyrjen parlamentare. Ata kanë marrë pjesë më rrallë në aktivitete ku institucionet e pavarura prezantojnë ndryshime ligjore të iniciuara nga këto të fundit, ku emërohen drejtuesit e institucioneve të pavarura ose ku miratohet planifikimi financiar.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e institucioneve të pavarura raportuan se janë angazhuar më shpesh në raportimin vjetor të aktiviteteve të institucioneve të tyre, në aktivitetet e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Parlamentit për institucionet e pavarura dhe rekomandimet që kanë bërë këto të fundit. Angazhimi i tyre me

Parlamentin në planifikimin dhe menaxhimin financiar raportohet si më pak i shpeshtë sesa raportimi dhe monitorimi vjetor (shih Figurën 1).


Figura 1: Përqindja e deputetëve dhe përfaqësuesve të institucioneve të pavarura që marrin pjesë shpesh/shumë shpesh në veprimtari të ndryshme të mbikëqyrjes parlamentare



Institucionet e pavarura janë pjesë e qeverisjes demokratike dhe ushtrojnë funksione mbikëqyrëse dhe rregullatore duke ndikuar në forcimin e vazhdueshëm të demokracisë. Performanca e tyre është e lidhur ngushtë me nivelin e paanshmërisë së tyre, përfshirë këtu pavarësinë nga ekzekutivi, të cilin ata duhet ta kontrollojnë. Sfida kryesore me të cilën përballen institucionet në vend është ndikimi politik në ushtrimin e veprimtarisë, i cili dobëson pavarësinë e tyre. Krerët e këtyre institucioneve emërohen kryesisht nga një shumicë e thjeshtë parlamentare (pa përfshirë Avokatin e Popullit, i cili zgjidhet me shumicë të cilësuar) dhe propozohen nga Këshilli i Ministrave. Gjithsesi, Parlamenti i Shqipërisë është tejet i polarizuar; ekzekutivi ka shumicën e vendeve në parlament dhe kontrollon edhe buxhetin e institucioneve të pavarura (buxheti i institucioneve të pavarura, përveç KLSH-së, propozohet nga ekzekutivi). Prandaj, çdo përfshirje e ekzekutivit jo vetëm në zgjedhjen e drejtuesve, por edhe në kompetencat për të miratuar akte nënligjore apo për të propozuar buxhetin e këtyre institucioneve ndikon në pavarësinë e tyre. Kësisoj, është e paqartë se si kryetarët e institucioneve të pavarura të mund të ruajnë pavarësinë e tyre nga ekzekutivi.

Në sondazh, përfaqësuesit e institucioneve të pavarura u pyetën për faktorët që ndikojnë në forcimin e institucioneve të pavarura. Plot 59% e tyre konstatojnë se kuadri ekzistues ligjor pengon konsolidimin institucional (shih Figurën 2). Zbatimi i ulët i rekomandimeve të këtyre institucioneve i atribuohet karakterit jo-detyrues të rekomandimit të tyre, siç përcaktohet në legjislacionin kombëtar. Në përgjithësi, kuadri ligjor për funksionimin e institucioneve të pavarura përputhet me standardet ndërkombëtare të njohura si Parimet e Parisit⁸ dhe u bën të mundur institucioneve të pavarura të përmbushin detyrat e tyre. Ndërhyrja politike perceptohet nga 68% e të anketuarve pa ndikim në forcimin e institucioneve të pavarura, ndërkohë që kapacitetet teknike të institucioneve të pavarura konsiderohen si faktor ndikues që ndikojnë më së shumti në forcimin e institucioneve të pavarura (shih Figurën 2).

Figura 2: Faktorët që ndikojnë në forcimin e institucioneve të pavarura sipas të anketuarve nga këto institucione




Një mbikëqyrje efektive parlamentare kërkon që Parlamenti të punojë ngushtësisht me institucionet e pavarura por duke siguruar që këto institucione të kenë kapacitete (në terma të pavarësisë institucionale dhe burimeve njerëzore dhe financiare) në ushtrimin e mandatit të tyre. Institucionet e pavarura, me 68 % e anketuesve, raportojnë se mbikëqyrja parlamentare ndikon në pavarësinë e institucioneve të pavarura (shih Figurën 3).

Një rekomandim i shpeshtë nga Parlamenti për institucionet e pavarura është forcimi i kapaciteteve të tyre dhe ndërtimi i burimeve njerëzore - një sugjerim që sigurisht

⁸ <http://nhhr.ohchr.org/EN/AboutUs/Pages/ParisPrinciples.aspx>.

vlen për të gjitha institucionet publike në Shqipëri⁹. Një mungesë në kapacitete teknike të institucioneve të pavarura bëhet pengesë për rolin e Parlamentit për të kuptuar dhe monitoruar institucionet e pavarura në planin afatgjatë. 68% e të anketuarve nga institucionet e pavarura e anketuara konfirmojnë se kapacitetet e tyre institucionale, veçanërisht kapacitetet njerëzore, janë përmirësuar nga “e moderuar” drejt “plotësisht” nga mbikëqyrja parlamentare (shih Figurën 3). Ky rezultat u konfirmua edhe nga intervista të thelluara me përfaqësues të institucioneve të pavarura, të cilët deklaruan “Parlamenti, përmes instrumentit të tij të mbikëqyrjes, ka mbështetur ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të pavarura, me qëllimin përfundimtar përmirësimin dhe forcimin e pavarësisë së tyre” nga “e moderuar” drejt “plotësisht”.¹⁰

Figura 3: Përqindja e të anketuarve që raportojnë se ndikimi i mbikëqyrjes parlamentare në forcimin institucional është “mesatar” deri “i lartë”.




Rezultatet e sondazhit dhe të intervistave të thelluara të realizuara për këtë studim tregojnë se edhe komunikimi mes Parlamentit dhe institucioneve të pavarura në Shqipëri perceptohet të jetë funksional. Vetëm një pakicë e deputetëve (13%) evidentojnë mungesën e komunikimit me institucionet e pavarura. Këto të fundit duket se e perceptojnë komunikimin e tyre me Parlamentin si zyrtar e mbështetës, ndërsa deputetët deklarojnë se Parlamenti është transparent dhe në favor të një mbikëqyrjeje më të mirë (shih Figurën 4). Në funksion të një mbikëqyrjeje efektive

⁹ Monitorimi nga Kuvendi i Shqipërisë i institucioneve të pavarura gjatë vitit 2018, *op. cit.*

¹⁰ Intervistë me përfaqësues të një institucioni të pavarur, 20 tetor 2020.

parlamentare kultura e punës ndërmjet parlamentit dhe institucioneve të pavarura duhet të mbështetet në besim të ndërsjellë.

Figura 4: Komunikimi mes institucioneve të pavarura dhe Parlamentit



Në vitin 2017, Parlamenti krijoi një mekanizëm të përbashkët ndërinstytucional për të përmirësuar rolin e tij mbikëqyrës.¹¹ Në varësi të përparësive dhe problemeve të secilit institucion, mekanizmi i monitorimit përcakton masat për koordinimin dhe zbatimin rast pas rasti. Një nga funksionet kryesore të këtij mekanizmi është të sigurojë një ndjekje të rekomandimeve të Parlamentit për ekzekutivin. Mekanizmi përfshin Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, roli i të cilit është të koordinohet me ekzekutivin për zbatimin e rekomandimeve nga institucionet e pavarura.¹² Sipas intervistave tona me përfaqësues të institucioneve të pavarura, roli i Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin duhet të jetë më aktiv (Shtojca 2: Përmbledhje e intervistave të thelluara).

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka krijuar një rrjet koordinatorësh në ministritë e linjës për të mbështetur procesin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Ky rrjet është përgjegjës edhe për monitorimin e progresit

¹¹ Vendimi Nr. 49/2017 i Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese”; Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 90, datë 27 prill 2017.

¹² Në Vendimin e Këshillit të Ministrave 11/2019, “Për përcaktimin e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shtetit dhe marrëdhëniet e saj me parlamentin”, Ministri, ndër të tjera, koordinon punën dhe trajton shqetësimet e institucioneve të pavarura ose institucioneve të tjera në lidhje me marrëdhëniet institucionale që ato kanë me Këshillin e Ministrave, ministritë ose autoritetet e ndryshme përgjegjëse shtetërore; harton projekte që trajtojnë organizimin dhe funksionimin e tyre; interesa të tjerë që ata kanë për projekte të ndryshme ose procesin legjislativ. Aksosuar për herë të fundit më 2 prill 2020, në adresën: <http://www.bmp.al/ep-content/uploads/2019/01/Fletorja-zyrtare.pdf>

dhe për raportimin. Raporti i parë vjetor mbi zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura u përgatit nga ministria dhe u dorëzua në vitin 2019, në seancën parlamentare të mbajtur për raportimin e institucioneve të pavarura.¹³

Në shtator 2019, Parlamenti krijoi Platformën Ndërinstitucionale Online për të promovuar një sistem transparent dhe një vlerësim më efikas të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura për organet ekzekutive dhe ato vartëse.¹⁴ Kjo platformë është pjesë e mekanizmit të monitorimit të përbashkët të ndërinstitucional dhe përbëhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, 6 nga 21 institucionet e pavarura që veprojnë në Shqipëri.¹⁵ Rrjeti i koordinatorëve të caktuar për të raportuar për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura trajnohen nga Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Në faqen e platformës në internet përshkruhen rekomandimet që i janë drejtuar ekzekutivit nga secili institucion i pavarur, por në këtë faqe ofrohet pak informacion se sa prej këtyre rekomandimeve janë (ose janë duke u) zbatuar. Nga ana tjetër, platforma nuk tregon qartë se kujt konkretisht nga ekzekutivi i drejtohen këto rekomandime, cilat janë rekomandimet aktuale, cili institucion i ka miratuar dhe si po zbatohen ato. Përfaqësuesi nga Parlamenti raportoi se në raportet e brendshëm të Shërbimit të Monitorimit në Parlament për vitet 2018 dhe 2019 jepet informacion i detajuar për rekomandimet.¹⁶

¹³ Komunikimi personal me Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, datë 15 dhjetor 2020.

¹⁴ Mima, Gjergji (2019), "Rritja e kontrollit parlamentar, prezantohet platforma ndërinstitucionale," Agjencia Telegrafike Shqiptare, aksesuar për herë të fundit më 2 prill 2020, në adresën: <https://ata.gov.al/2019/09/13/rritje-e-kontrollit-parlamentar-prezantohet-platforma-nderinstitutonale-online/>

¹⁵ Mekanizmi i Platformës Ndërinstitucionale, aksesuar për herë të fundit më 15 gusht 2020, në adresën: <http://134.0.63.165:5000/public> Nga dita kur u aksesua për herë të fundit deri më sot, faqja online nuk ka përditësime të reja dhe të dhënat janë ende të vitit 2018, me komentet në këtë seksion në platformën online që janë ende aty.

¹⁶ Komunikimi personal me Shërbimin e Monitorimit në Kuvend, 19 dhjetor 2020

Deri tani, Parlamenti i Shqipërisë ka rezultuar joefektiv për të detyruar zbatimin e rekomandimeve që institucionet e pavarura u kanë drejtuar ekzekutivit dhe institucioneve të tjera publike. Hulumtimi konstatoi tre arsye: a) Përdorim i kufizuar i tërësisë së instrumenteve procedurale për mbikëqyrjen parlamentare të institucioneve të pavarura të përdorura nga komisionet parlamentare; b) ndërveprim i kufizuar mes Parlamentit, ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura për trajtimin e rekomandimeve; dhe c) angazhimi jo proaktiv i Ministrisë së Shtetit të Marrëdhënieve me Parlamentin.


a. Përdorim i kufizuar i instrumenteve procedurale

Nga perspektiva mbikëqyrëse deputetët e parlamentit kanë një tërësi mjetesh që përfshijnë mbikëqyrjen e komisioneve parlamentare, mbikëqyrjen në seancë plenare dhe mbikëqyrjen e buxhetit. Instrumentet procedurale të mbikëqyrjes parlamentare janë të detajuara në Rregulloren e Parlamentit dhe përfshijnë të tilla si marrja dhe shqyrtimi i raporteve vjetore/periodike, interpelancat, pyetjet me gojë e me shkrim, raportet dhe rekomandimet, etj. Sipas nenit 102 të Rregullores, deputetët mund të kërkojnë shpjegime nga institucionet dhe të thërrasin komisione të posaçme për të trajtuar çështjet. Drejtuesit e institucioneve publike, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Për më tepër, komisionet e përhershme mund të kryejnë kontrolle ose të kërkojnë dokumente brenda fushave të tyre të përgjegjësisë që ata i konsiderojnë të nevojshme për shqyrtimin e një çështjeje të caktuar dhe përgatisin një raport.

Siç u tha edhe më sipër, deputetët dhe institucionet e pavarura të anketuara në këtë studim identifikuan raportimin vjetor në Parlament si instrumentin më të zakonshëm dhe më efikas të mbikëqyrjes (shih Figurat 1 dhe 5). Edhe deputetët e anketuar raportojnë se interpelancat parlamentare janë shumë efikase në procesin e mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura. Këto të fundit raportojnë se raportet vjetore janë një instrument efikas i mbikëqyrjes së Parlamentit. Një numër i madh institucionesh të pavarura (64%) i konsiderojnë takimet e komisioneve për çështje që janë kompetencë e tyre dhe që kërkohen nga këto të fundit si mjet i dobishëm dhe 53% e deputetëve bien dakord me këtë pikë (shih Figurën 5). Platforma elektronike e

monitorimit për monitorimin dhe raportimin e zbatimit raportohet si instrument shumë efektiv nga deputetët dhe institucionet e pavarura me rreth 60% .

Figura 5: Përqindja e deputetëve dhe institucioneve të pavarura që raportojnë se instrumentet e mbikëqyrjes janë efektive/shumë efektive



b. Ndërveprim i kufizuar mes Parlamentit, ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura


Mekanizmi i përbashkët për monitorimin sistematik të rekomandimeve të bëra nga institucionet e pavarura u krijua pikërisht për monitorimin efikas të ndjekjes dhe zbatimit të tyre. Që nga fillimi, mekanizmi i kushtoi vëmendje të veçantë zbatimit të rekomandimeve nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, organi më i rëndësishëm i mbikëqyrjes në vend.¹⁷ Në vitin 2018, në një takim me institucionet e pavarura, Ministri i Shtetit vuri në dukje se 50% e rekomandimeve ishin zbatuar dhe procesi i përmbushjes së rekomandimeve ishte në vazhdim e sipër.¹⁸ Sipas raporteve vjetore për 2018 dhe 2019

¹⁷ Vendimi Nr. 49/2017 i Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”;

¹⁸ Fjalimi i Ministrisë për Marrëdhëniet me Parlamentin në Takimin e Parë Vjetor të Kryetarit të Kuvendit me institucionet e pavarura, aksesuar për herë të fundit më 5 prill 2020 në: <https://ata.gov.al/2019/04/12/institucionet-e-pavarura-spiropali-zbatim-i-plate-i-rekomandimeve/>

për katër institucionet e pavarura të shqyrtuara këtu, niveli i zbatimit të rekomandimeve të tyre nga organet ekzekutive dhe institucionet e tyre të varësisë nuk ka qenë optimal (shih Figurën 6). Për shembull, nga 130 rekomandime nga Avokati i Popullit për qeverinë qendrore, vetëm 25 ishin zbatuar, 47 nuk ishin përmbushur, për 24 të tjerë nuk kishte asnjë ndjekje të mëtejshme, 10 rekomandime u refuzuan dhe dy ishin çuar në gjykatë. Rekomandimet e mbetura nuk ishin trajtuar fare. Shkalla e ulët e zbatimit të rekomandimeve nga administrata publike, vonesat ose mungesa në dhënien e shpjegimit të duhur me përgjigje ndaj institucioneve të pavarura pengon procesin e mbikëqyrjes (shih Figurën 6). Avokati i Popullit shpjegon se institucionet publike priren të zbatojnë një rekomandim nëse ky i fundit lidhet me një çështje të veçantë. Një përfaqësues i intervistuar i institucioneve të pavarura shpjegoi: “nëse rekomandimi trajton një problem strukturor ose një çështje të rëndësishme që lidhet me zbatimin e të drejtave të njeriut, ai zakonisht nuk zbatohet.”

Figura 6: Rekomandimet nga institucionet e pavarura për organet ekzekutive dhe njësitë e varësisë, 2018




Burimi: Monitorimi nga Parlamenti i Shqipërisë për institucionet e pavarura gjatë vitit 2018¹⁹

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbikëqyr qeverinë qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe institucionet e tjera publike. Duke pasur parasysh numrin e madh dhe

¹⁹ Monitorimi gjatë vitit 2018, aksesuar për herë të fundit më 21 shtator 2020, në adresën: <http://134.0.63.165:5000/Botim2018.pdf>

kategoritë e ndryshme të rekomandimeve të KLSH-së, të dhënat paraqiten në dy figura të ndryshme më poshtë, pasi ato përfaqësojnë dy vite të ndryshme (2017- të dhëna nga Parlamenti dhe 2018 - të dhëna nga KLSH). Figura 8 përpilon të dhëna nga viti 2017, sepse informacioni për monitorimin e rekomandimeve të vitit 2018 për raportin e KLSH nuk është i disponueshëm në faqen online të Parlamentit. Të dhënat e vetme nga 2018 (në Figurën 7) kanë të bëjnë me numrin e rekomandimeve duke u bazuar në fusha specifike. Nga shqyrtimi i raportit të monitorimit të Parlamentit për 2018, që është edhe raporti i parë i këtij lloji, vëmë re se të dhënat e përdorura për hartimin e këtij raporti për KLSH-në ishin të dhënat e vitit 2017. Kjo për arsye se ndjekja e ecurisë dhe zbatimi i rekomandimeve për KLSH zgjatet për një periudhë më të gjatë kohore sesa për institucionet e tjera të pavarura, statusi i rekomandimeve për vitin 2017 pasqyrohet deri në fund të vitit 2019.

Figura 7: Rekomandimet e KLSH-së për institucionet e auditit, 2018




Burimi: Raporti Vjetor i Performancës i KLSH-së 2018 ²⁰

Në krahasim me të dhënat e vitit 2017, ka një rritje të numrit të masave që janë dhënë nga KLSH për institucionet publike të audituara. Siç sugjerohet edhe në Figurën 7, KLSH dha 4232 masa (shuma e të gjitha masave në figurë) ose 711 më shumë se në 2017 (Figura 8), nga të cilat 118 janë masa për përmirësime ligjore, 2942 masa organizative, 861 masa disiplinore dhe 311 masa administrative. Sipas raportit të KLSH-së 2018, disa nga shkeljet më thelbësore të audituara janë në fushat e të ardhurave dhe menaxhimit të buxhetit, në administrimin e pronës shtetërore dhe në

²⁰ Raporti Vjetor i Performancës 2018 i KLSH-së, aksesuar për herë të fundit më 23 gusht 2020, në adresën: http://www.klsh.org.al/ëeb/raporti_performances_2018_4788.pdf

prokurimin publik²¹. Rritja e numrit të masave që kanë si synim institucionet mund të tregojë një kontroll më nga afër dhe më efektiv nga KLSH.

Figura 8: Rekomandimet e KLSH-së për institucionet e audituara, janar-dhjetor 2017



Burimi: Monitorimi nga Parlamenti i Shqipërisë për institucionet e pavarura gjatë vitit 2018²²

Për të monitoruar dhe siguruar efektivitetin e institucioneve të pavarura, Parlamenti i ka miratuar Vendimin Nr. 134/2018 “Për Miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”. Rregulloret e përfshira në manualin e monitorimit përcaktojnë se në raportet e tyre vjetore dhe periodike, institucionet e pavarura duhet të përfshijnë ndër të tjera edhe rekomandimet e “Dokumentit të Punës të Stafit të Komisionit - Raporti i Shqipërisë 2019” dhe sa janë përmbushur ato. Ata duhet të shtojnë edhe një listë të rekomandimeve që kanë nxjerrë për institucionet që janë subjekt monitorimi si dhe një raport nëse këto rekomandime janë zbatuar.


Të gjitha institucionet e pavarura raportojnë rregullisht në Parlament dhe raportet e tyre diskutohen në komisionet përkatëse të Parlamentit. Pas paraqitjes dhe shqyrtimit të raporteve në Parlament, bëhet një vlerësim i performancës së institucioneve të pavarura. Në vijim të vlerësimit, Parlamenti harton rekomandime drejtuar

²¹ Po aty.

²² Monitorimi gjatë vitit 2018, aksesuar për herë të fundit më 23 gusht 2020, në adresën: <http://134.0.63.165:5000/Botim2018.pdf>

institucioneve të pavarura. Nga shqyrtimi i rekomandimeve si edhe raporteve vjetore të institucioneve të pavarura ndër vite, kemi konstatuar se rekomandimet janë riformulim i detyrave që iu janë caktuar atyre në raportet përkatëse. Rekomandimet e nxjerra nga Parlamenti në drejtim të institucioneve të pavarura nuk parashikojnë vijueshmëri të ndjekjes së tyre me procedura, procese apo mekanizma ekzistues të monitorimit të zbatimit të tyre. Në Figurën 9 më poshtë jepet raporti i statusit të rekomandimeve të Parlamentit për institucionet e pavarura.

Figura 9: Rekomandimet e dhëna nga Parlamenti për institucionet e pavarura, 2018²³



Sipas informacionit zyrtar të marrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga nëntë rekomandimet e dhëna nga Parlamenti në rezolutën e miratuar më 19/04/2018 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2017”, vetëm katër janë zbatuar plotësisht dhe katër të tjerë pjesërisht, ndërsa një rekomandim nuk është zbatuar fare.


Nga 6 rekomandime të adresuara nga Parlamenti në rezolutën e miratuar më 30.05.2019 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2018” rezultojnë se deri në dhjetor 2019 janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime ndërsa 1 është në proces zbatimi. Ndërsa 12 rekomandimet e miratuara për Komisionerin për

²³ Monitorimi i institucioneve të pavarura nga Kuvendi i Shqipërisë gjatë 2018, cituar nga <http://134.0.63.165:5000/Botim2018.pdf>

të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë zbatuar plotësisht. Nga 11 rekomandimet e miratuara në rezolutën e datës 11.04.2019 për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018, 10 rekomandime janë zbatuar plotësisht, ndërsa 1 është i paplotësuar (shih figurën 10).

Në “Monitorimin nga Parlamenti i Shqipërisë për institucionet e pavarura gjatë vitit 2018”, një numër i vogël rekomandimesh që janë dhënë për institucionet e pavarura përmenden sipas emrit dhe nëse rekomandimi është zbatuar apo jo. Me qëllim krahasimi, shumë rekomandime të tjera referohen thjesht me numër. Për shembull, thuhet se “Pesë rekomandime nuk janë përfunduar” - pa dhënë ndonjë detaj tjetër të veçantë për të evidentuar se cilat janë këto rekomandime. Një nga rekomandimet e papërbushura të përmendura me emër i drejtohet Avokatit të Popullit dhe ka të bëjë me krijimin e një sistemi të ri online për administrimin e ankesave për të zëvendësuar sistemin që daton që nga viti 2002. Rekomandimi nuk është përbushur për shkak të mungesës së fondeve, që Parlamenti duhet t’i akordojë Avokatit të Popullit. Konstatim i njëjtë është vërejtur edhe në raportin e fundit të monitorimit të Parlamentit për vitin 2019. Ndonëse raportohet një nivel i lartë i përbushjes së rekomandimeve nga institucionet e pavarura në raportet e monitorimit të Parlamentit, ky raport nuk shoqërohet me metodologjinë e përdorur për matjen e nivelit të realizimit apo zbatimit të rekomandimeve.

Figure 10: Rekomandimet e dhëna nga Parlamenti për institucionet e pavarura–2019



Shënim: Bazuar në të dhënat e mbledhura nga Shërbimi i Monitorimit në Parlamentin Shqiptar, nuk ka asnjë rezolutë të Parlamentit për KLSH për vitin 2019.²⁴

c. Angazhim jo proaktiv i Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Udhëzimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 134/2018 sugjerojnë që, të paktën një herë në vit, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin të hartojë dhe t'i propozon Këshillit të Ministrave një raport për situatën e zbatimit të rekomandimeve që institucionet e pavarura i kanë drejtuar ekzekutivit. Çdo gjashtë muaj, Ministri pritet të informojë Kryetarin e Parlamentit në lidhje me gjetjet e auditimit të kryera nga KLSH dhe që kanë si synim institucionet qendrore dhe njësitë e tyre të varësisë. Për më tepër, raporti i monitorimit synon të përditësojë statusin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH (kategorizuar sipas institucioneve ku është kryer kontrolli) dhe arsyet pse institucionet refuzojnë të zbatojnë rekomandimet.

Ministri i Shtetit i ka paraqitur Kryetarit të Parlamentit raporte 6-mujore dhe vjetore për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura për ekzekutivin, siç përcaktohet në udhëzimet e manualit vjetor dhe periodik të monitorimit²⁵, por këto raporte nuk janë publikuar. Rrjeti i koordinatorëve të ngritur në ministrinë e linjës i shtrin kapacitetet e kufizuara në nivel ministrie. Megjithatë, përfaqësuesit e institucioneve të pavarura të intervistuar për këtë studim raportojnë se u mungon komunikimi me Ministrinë në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve²⁶. Për më tepër, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka ende një numër të vogël personeli dhe funksionon me kapacitete të kufizuara të brendshme.

²⁴ Raport i Kryetarit të Kuvendit për monitorimin e institucioneve të pavarura, shkurt 2021, aksesuar për herë të fundit në 2 mars 2021:

http://134.0.63.165:5000/Raport%20i%20Kryetarit%20te%20Kuvendit%20mbi%20punen%20e%20Kuvendit%20me%20institucionet%20e%20pavarura_compressed.pdf

²⁵ Komunikimi personal me Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, datë 15 dhjetor 2020.

²⁶ Intervistë me përfaqësues të një institucioni të pavarur, 20 tetor 2020.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Instrumentet dhe proceset e mbikëqyrjes së Parlamentit nuk janë përdorur në potencialin e tyre të plotë, sepse anëtarët e Parlamentit mbështeten posaçërisht në raportimin vjetor të institucioneve të pavarura, krahasuar me instrumentet e tjera. Mekanizmi i përbashkët ndërinstitucional për monitorimin sistematik të rekomandimeve të nxjerra nga institucionet e pavarura u krijua pikërisht me qëllim trajtimin e këtyre mangësive përmes monitorimit efikas të ecurisë dhe zbatimit. Gjithsesi, deri më sot nuk ka ndonjë raport të Parlamentit për efektshmërinë apo ecurinë e zbatimit të këtij mekanizmi. Për shkak të mungesës së bashkëpunimit institucional mes Parlamentit, qeverisë dhe institucioneve të pavarura, zbatimi i rekomandimeve të hartuara nga këto të fundit për qeverinë është ende në nivel të ulët.

Prandaj, kemi hartuar rekomandimet e mëposhtme që i drejtohen Parlamentit, institucioneve të pavarura dhe Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin .

Parlamenti në përdorim sa më të mirë të mirë të kompetencave mbikëqyrëse:

- Të forcojë marrëdhëniet me institucionet e pavarura të mbikëqyrjes dhe të sigurojë që këto institucione të kenë kapacitete (në lidhje me pavarësinë, burimet njerëzore dhe financiare) për të përmbushur mandatin e tyre. Parlamenti dhe institucionet e pavarura duhet të krijojnë një kulturë besimi të ndërsjellë duke punuar bashkërisht në mënyrë sistematike dhe në kohë, duke përdorur tërësinë e mekanizmave të krijuar për shqyrtimin e raporteve dhe për të ndërmarrë veprime të mëtijshme sipas nevojës. Kjo bën të mundur që Parlamenti të jetë i sigurt në gjetjet dhe rekomandimet e organeve të pavarura dhe që këto të fundit të jenë të sigurt se Parlamenti ka vullnetin e duhur për të marrë seriozisht rekomandimet e tyre.
- Të krijojë një mekanizëm gjithëpërfshirës për të vlerësuar nëse janë përmbushur kushtet për mbikëqyrje efektive dhe të propozojë përmirësime aty ku është e nevojshme. Mekanizmi të përfshijë vlerësimin se sa të mjaftueshme janë rregullat dhe procedurat e vendosura, kapacitetet parlamentare për mbikëqyrje, metodologjinë e monitorimit për zbatimin e rekomandimeve, etj. Të kryhet duke marrë parasysh këtë qasje edhe një vlerësim i efektivitetit të mekanizmave aktual, siç është mekanizmi i përbashkët për monitorimin sistematik të rekomandimet e institucioneve të pavarura ose platforma institucionale në internet.
- Të sigurojë që ekzistojnë edhe sisteme për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura për qeverinë si dhe veprimet që ndërmerret qeveria

ndaj këtyre rekomandimeve. Është veçanërisht e rëndësishme të mbahen evidenca të angazhimeve që ndërmerr qeveria për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga institucionet e pavarura. Por ndjekja e rekomandimeve të institucioneve të pavarura është një përgjegjësi e përbashkët me qeverinë. Dakordësimi i një sistemi me ekzekutivin ku ky i fundit të jetë i detyruar të japë përgjigje zyrtare për zbatimin e rekomandimeve dhe statusin e tyre brenda një afati kohor të caktuar. Qasja sistematike ndihmon në përqendrimin e vëmendjes së qeverisë dhe Parlamentit të rekomandimet e institucioneve të pavarura.

- Të përmirësohen kapacitetet teknike të Parlamentit me ekspertizë në: vlerësimin e raporteve vjetore të institucioneve të pavarura, për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura si dhe rekomandimeve për këto të fundit të lëna nga Parlamenti i Shqipërisë.

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin:

- Të ketë një angazhim më proaktiv ndaj mirëfunksionimit të mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Ai duhet të synojë rritjen e numrit të stafit për të nxitur një komunikim më efektiv dhe në kohë me institucionet e përfshira në mekanizmin e përbashkët.

Institucionet e pavarura:

- Të angazhohen në nisma më proaktive me komisionet përkatëse parlamentare për të kuptuar më mirë aktivitetin e tyre dhe për të mundësuar mbështetjen e Parlamentit në lidhje me performancën e tyre në zbatimin e rekomandimeve nga ekzekutivi.
- Të përmirësojnë mekanizmat institucionalë të mbikëqyrjes dhe të rrisin kapacitetet teknike institucionale për zbatimin e tyre.

SHTOJCAT

Shtojca 1. Pyetësor me deputetët dhe institucionet e pavarura (N=47)

Institucionet e pavarura	Tiparet e kampionit	Deputeti	Tiparet e kampionit
Loji i institucioneve	Shpeshtësia (në %)	Grup parlamentar	Shpeshtësia (në %)
Institucion rregullator	22,7%	Grupi parlamentar demokrat	20,0%
Institucion i pavarur	22,7%	Grupi parlamentar socialist	33,3%
Mbikëqyrës i Ekzekutivit	54,5%	I pavarur	46,7%
Gjithsej	100,0%	Gjithsej	100,0%
Pozicioni i punës	Shpeshtësia (në %)	Mandati si deputet	Shpeshtësia (në %)
I paraportuar	18,2%	Mandati i parë	60,0%
Nivel drejtues	50,0%	Mandati i dytë	26,7%
Staf politik	4,5%	Mandati i tretë	13,3%
Staf teknik	27,3%	Gjithsej	100,0%
Gjithsej	100,0%	Grupmosha	Shpeshtësia (në %)
Përvoja e punës	Shpeshtësia (në %)	18-35 vjeç	13,3%
I paraportuar	18,2%	35-55 vjeç	46,7%
Deri në 5 vjet përvojë pune	68,2%	Mbi 55 vjeç	40,0%
Mbi në 5 vjet përvojë pune	13,6%	Gjithsej	100,0%
Gjithsej	100,0%	Gjinia	Shpeshtësia (në %)
Mosha	Shpeshtësia (në %)	Femër	46,7%

Institucionet e pavarura	Tiparet e kampionit	Deputeti	Tiparet e kampionit
Pa përgjigje	18,2%	Mashkull	53,3%
18-35 Vjeç	27,3%	Gjithsej	100,0%
35-45 Vjeç	40,9%	Pjesëmarrës në komisionet parlamentare	Shpeshtësia (në %)
Mbi 45 Vjeç	13,6%	Jo, nuk marr pjesë	26,7%
Gjithsej	100,0%	Po, marr pjesë	73,3%
Gjinia	Shpeshtësia (në %)	Gjithsej	100,0%
Femër	59,1%	Komision parlamentar	Shpeshtësia (në %)
Mashkull	40,9%	Nuk marr pjesë në asnjë komision	26,7%
Gjithsej	100,0%	Komisioni për Arsimin dhe Informimin	40,0%
Arsimi	Shpeshtësia (në %)	Komisioni për Ligjet dhe Sigurinë Kombëtare	20,0%
I mesëm	22,7%	Komisioni për Ekonominë dhe Financat	6,7%
Universitar	18,2%	Komisioni për Punësimin dhe Çështjet Sociale	6,7%
Pasuniversitar	59,1%	Gjithsej	100,0%
Gjithsej	100,0%		

Shtojca 2. Pikat kryesore nga intervistat e thelluara me institucionet e pavarura

Instrumentet kryesore të mbikëqyrjes parlamentare i nënshtrohen: Raporteve periodike për aktivitetin, rezultatet, rekomandimet dhe menaxhimin financiar janë instrumentet kryesore, me të cilat institucionet e pavarura raportojnë se angazhohen me komisionet parlamentare. Institucionet e pavarura kontribuojnë vazhdimisht në hartimin e ligjeve duke dhënë mendimet e tyre për nismat ligjore. Edhe kontributi në platformën online të monitorimit është i rëndësishëm për angazhimin e institucionit me Parlamentin. Institucionet raportojnë se kanë organizuar vizita në terren për komisionet parlamentare përgjegjëse për mbikëqyrjen e tyre, ndërkohë që të gjithë intervistuesit raportuan se marrëdhënia e institucionit të tyre me Parlamentin është e shkëlqyer dhe shumë mbështetëse për aktivitetin dhe forcimin e tyre institucional.

Si i perceptoni ndikimet e mbikëqyrjes parlamentare në veprimtarinë e institucioneve tuaja: Mbikëqyrja parlamentare e institucioneve tona nuk ndikon shumë në aktivitetin tonë. Gjithsesi, i ndjekim nga afër të gjitha rekomandimet e Parlamentit. Rezoluta parlamentare për veprimtarinë e institucionit tonë vepron për ne si udhëzues për punën në të ardhmen. Mbikëqyrja parlamentare ka mbështetur forcimin institucional dhe përmirësimin e kapaciteteve si dhe rritjen e pavarësisë së institucionit. (KMD) “Mbikëqyrja parlamentare vepron si mekanizëm motivues për institucionet tona që çon drejt përmirësimit të performancës dhe rezultateve tona.” (Avokati i Popullit)

A prisni që Parlamenti të forcojë rolin e institucioneve të pavarura në monitorimin e institucioneve publike: Mënyra më e mirë për parlamentin për të përmirësuar efektivitetin e institucionit të pavarur është t’i mbështesë ato në monitorimin e institucioneve publike (qendrore dhe në qarqe) dhe t’i detyrojë ato të miratojnë dhe zbatojë rekomandimin e institucionit të pavarur. Platforma online e monitorimit mundëson një monitorim efektiv të zbatimit të rekomandimeve. Për Avokatin e Popullit mbetet sfidë niveli i miratimit të institucioneve publike dhe reflektimi mbi rekomandimin e dhëna prej tij. “Besojmë se jo vetëm institucioni publik, por edhe Parlamenti duhet të marrë një rol udhëheqës për të detyruar ekzekutivin për të pranuar dhe zbatuar rekomandimet e institucioneve të pavarura. Në këtë aspekt, platforma online e monitorimit nuk është e mjaftueshme. Shqipëria mund të ndjekë shembullin e Kosovës.

Si mund t'i ndihmojë Mbikëqyrja e Parlamentit institucionet e pavarura për forcimin e rolit të tyre: Mënyra e vetme për të përmirësuar efektivitetin e autoriteteve të pavarura është forcimi i kapaciteteve të tyre dhe përmirësimi i statusit të komisionerëve në marrëdhëniet e tyre me nëpunësit administrativë që monitorojnë/kontrollojnë. Ndonjëherë duket e vështirë të hetohen rastet kur autoriteti nën hetim renditet më lart se komisionerët. Besojmë se burokracia dhe mungesa e koordinimit mes institucioneve ekzekutive dhe atyre të pavarura duhet të trajtohet nga Ministri i Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin, ministër që duhet të jetë më aktiv. Informimi publik dhe rritja e ndërgjegjësimit do të ndihmonin në forcimin e rolit dhe ndikimit tonë institucional. Forcimi i rolit të Parlamentit në kontrollin/ekuilibrimin e pushtetit ekzekutiv do të çonte në forcimin e institucioneve të pavarura. Parlamenti duhet të identifikojë dhe mbështesë edhe mekanizmat që detyrojnë zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura, rekomandime që duhet të zbatohen dhe marrin seriozisht nga ekzekutivi. Roli dhe zhdërvjelltësia e Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin do të përmirësonte rolin dhe kontributin e institucioneve të pavarura për të mirën publike. Përfshirja e monitorimit të statusit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura në kuadër të Raportimit të Komisionit të BE do të mundësonte zbatimin e rekomandimeve të autoriteteve të pavarura.

Shtojca 3. Lista e figurave

Figura 11: Përqindja e deputetëve që marrin pjesë në veprimtari të ndryshme të mbikëqyrjes parlamentare




Figura 12: Frekuenca e institucioneve të pavarura në pjesëmarrje për veprimtari të mbikëqyrjes parlamentare




Figura 13: Efektiviteti i mekanizmeve të ndryshëm të mbikëqyrjes parlamentare, të raportuara nga deputetet e Parlamentit




Figura 14: Efektiviteti i mekanizmeve të ndryshme të mbikëqyrjes parlamentare të raportuara nga deputetët e Parlamentit




Figura 15: Efektiviteti i mekanizmave të ndryshme të mbikëqyrjes parlamentare të raportuara nga institucionet e pavarura




Figura 16: Ndikimi i mbikëqyrjes parlamentare tek institucionet e pavarura sipas raportimit të vetë institucioneve të pavarura




Figura 17: Faktorët që ndikojnë në forcimin e institucioneve të pavarura, sipas raportimit nga përfaqësuesit e institucioneve të pavarura





Figura 18: Faktorët që ndikojnë në forcimin e institucioneve të pavarura, sipas raportimit nga deputetët e Parlamentit



Shtojca 4. Pyetësi për deputetët

I. Informacion i përgjithshëm

1. Partia politike që përfaqësoni:

Partia Socialiste

Partia Demokratike

Lëvizja Socialiste për Integrim

Tjetër, lutemi përcaktojeni

2. Mandati juaj si ligjvënës në Parlament është:

I pari

I dyti

I treti

Kam më shumë se tre mandate

3. Lutemi më thoni cilës grupmoshe i përkisni:

18-35 vjeç

35-45 vjeç

45-55 vjeç

mbi 55 vjeç

4. Lutemi thoni gjininë tuaj:

Mashkull Femër

5. Lutemi identifikoni fushën e studimit/profesionit:

Arsim/mësimdhënie

Art

Shkenca sociale, gazetari, politikë

Ekonomi, biznes, ligje

Shkenca natyrore

Teknologji e informacionit

Inxhinieri/ Përpunim/Ndërtim

Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinar

Shkenca mjekësore

Tjetër

6. A merrni pjesë në ndonjë komision mbikëqyrës parlamentar të institucioneve të pavarura?

| ____ | Po, | ____ | Jo (Nëse jo, përfundoni intervistën)

7. Nëse 'Po', lutemi përcaktoni komisionet parlamentare që ushtrojnë funksione mbikëqyrëse të institucioneve të pavarura në të cilat keni marrë pjesë apo po merrni pjesë aktualisht (shkruaje më poshtë):

II. Aktiviteti parlamentar në mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe efikasiteti i tij:

8. Duke iu referuar aktivitetit tuaj parlamentar në lidhje me mbikëqyrjen parlamentare të institucioneve të pavarura, lutemi raportoni nëse keni marrë pjesë në ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme. Mund të zgjidhni mes opsioneve të renditura ose të shpjegoni përvojën tuaj.

| ____ | Interpelancë parlamentare;

| ____ | Takim i komisionit parlamentar i mbledhur nga deputetët;

| ____ | Takim i planifikuar i komisionit parlamentar, që i kushtohet raportimit vjetor të institucioneve të pavarura;

| ____ | Takim i komisionit parlamentar i kërkuar nga vetë institucioni i pavarur;

| ____ | Takim i komisionit parlamentar i kërkuar nga palë të tjera (specifikojeni);

| ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni _____

9. Duke iu referuar aktivitetit tuaj parlamentar, lutemi raportoni, mesatarisht, sa shpesh keni marrë pjesë në aktivitete në lidhje me mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura:

| ____ | Deri në 2 herë në vit

| ____ | 2 deri në 5 herë në vit

| ____ | Më shumë se 5 herë në vit

| ____ | Nuk më kujtohet

| ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni _____

10. Duke iu referuar aktivitetit tuaj parlamentar në lidhje me mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura, lutemi raportoni si e konsideroni pjesëmarrjen e kolegëve tuaj në këto aktivitete:

- | ____ | Pjesëmarrje e plotë;
- | ____ | Pjesëmarrje e plotë, por kontributi është modest dhe i politizuar;
- | ____ | Pjesëmarrje modeste, marrin pjesë dhe kontribuojnë vetëm ata kolegë që kanë njohuri teknike;
- | ____ | Pjesëmarrje modeste, marrin pjesë dhe kontribuojnë vetëm ata kolegë që përfaqësojnë grupet e interesit
- | ____ | Pjesëmarrje e ulët, dhe kontribut i vogël në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës të institucioneve të pavarura
- | ____ | Tjetër, lutemi komentoni _____

11. Lutemi raportoni sa shpesh keni diskutuar temat e mëposhtme në lidhje me funksionin e mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura. Nëse keni më shumë se një mandat, lutemi merrni parasysh të gjitha mandatet dhe raportoni një vlerë mesatare. Përdorni shkallën e mëposhtme të vlerësimit: 1- shumë shpesh, 2- shpesh, 3- ndonjëherë, 3- rrallë, 4- shumë rrallë, 5- kurrë:

- | ____ | Pranimi dhe diskutimi i raporteve vjetore të veprimtarisë së institucioneve të pavarura
- | ____ | Pranimi dhe diskutimi i rezultateve të punës së institucioneve të pavarura
- | ____ | Pranimi dhe prezantimi i rekomandimeve të institucioneve të pavarura për përmirësimin e funksionimit të ekzekutivit
- | ____ | Pranimi dhe prezantimi i kandidaturave për drejtues të institucioneve të pavarura
- | ____ | Prezantimi i nismave ligjore
- | ____ | Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve për ekzekutivin
- | ____ | Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të nxjerra nga Parlamenti për institucionet e pavarura
- | ____ | Menaxhimi financiar i institucionit
- | ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni:

12. Lutemi jepni vlerësimin tuaj perceptues të komunikimit me institucionet e pavarura për të cilat jeni të angazhuar në aktivitete mbikëqyrëse si deputet/e:

- | ____ | Komunikimi me institucionin e pavarur është transparent dhe bashkëpunues
- | ____ | Komunikimi është formal por bashkëpunues dhe ndihmon në procesin e mbikëqyrjes

| _____ | Komunikimit i mungon transparenca dhe bashkëpunimi, gjë që e bën të vështirë realizimin e mbikëqyrjes efektive

| _____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni: _____

13. Bazuar në veprimtarinë tuaj parlamentare, që lidhet me funksionin e mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura, lutemi raportoni cili nga instrumentet e mëposhtëm është më efektiv në kryerjen e mbikëqyrjes parlamentare: Përdorni shkallën e mëposhtme të vlerësimit: 1- shumë efektiv, 2- efektiv, 3- disi efektiv, 4- aspak efektiv, 5- nuk e di;

| _____ | raporte në interpelancë në Parlament

| _____ | raportimi periodik, me shkrim, sipas kërkesave të ligjit

| _____ | Takime me komisionin parlamentar të ndërmarrë nga vetë institucioni i pavarur

| _____ | Sistem/platformë elektronike për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të rekomandimeve

| _____ | Raporte të pavarura të autorizuara nga komisioni parlamentar për vlerësimin e aktivitetit të institucioneve për zbatimin e rekomandimeve

| _____ | Kontrolle apo kërkesa për dokumentacione që i konsiderojnë të nevojshme ndaj institucioneve shtetërorë për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura

| _____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni _____

14. Bazuar në përvojën tuaj dhe veprimtarinë parlamentare, që ka të bëjë me funksionin e mbikëqyrjes parlamentare të institucioneve të pavarura, si do ta vlerësonit ndikimin e mbikëqyrjes në aspektet e mëposhtme të ngritjes dhe forcimit të institucioneve të pavarura. Për të shprehur shkallën e ndikimit Ju lutemi përdorni vlerësimin si më poshtë: 1- e lartë, 2- mesatare, 3- e ulët, 3- pa ndikim, 5- nuk e di.

| _____ | Forcimi i pavarësisë së institucionit

| _____ | Forcimi i kapacitetit të institucionit

| _____ | Roli i institucioneve të pavarura në kontrollin ekzekutiv është forcuar pas procesit të mbikëqyrjes parlamentare

| _____ | Transparenca dhe përgjegjësia e institucionit janë përmirësuar

| _____ | Ndikimi i institucionit të pavarur në të mirën publike dhe politikëbërjen është forcuar

| _____ | Menaxhimi financiar i institucionit është përmirësuar

| _____ | Mbikëqyrja ka forcuar rolin e institucioneve të pavarura në luftën kundër korrupsionit

| _____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni _____

15 Bazuar në përvojën tuaj dhe veprimtarinë parlamentare, që ka të bëjë me funksionin e mbikëqyrjes parlamentare të institucioneve të pavarura, cili nga aspektet e mëposhtme është pengesa kryesorë në forcimin e rolit dhe ndikimit të institucioneve të pavarura?

| ____ | Shkalla e ndikimit të politikave në veprimtarinë dhe vendimet e institucioneve të pavarura

| ____ | Kapacitetet teknike të institucioneve të pavarura

| ____ | Kapacitetet mbikëqyrëse të institucioneve të pavarura

| ____ | Shpesh është kuadri ligjor që nuk bën të mundur materializimin e fuqizimit dhe potencialit të institucioneve të pavarura

| ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni.

Shtojca 5. Pyetësi për institucionet e pavarura

1. Informacion i përgjithshëm për institucionin dhe personin që e plotëson pyetësi

1. Institucioni i pavarur që përfaqësoni

2. Funkcioni i institucionit tuaj

| ____ | Mbikëqyrës i ekzekutivit

| ____ | Autoritet/agjenci rregullatore

| ____ | Tjetër

3. Lutemi thoni pozicionin tuaj në institucionin që përfaqësoni

| ____ | Drejtor/Mbikëqyrës

| ____ | Pozicion teknik që lidhet me natyrën dhe aktivitetin e institucionit

| ____ | Pozicion teknik administrativ

| ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni: _____

4. Lutemi thoni sa vite punë keni në këtë institucion, pavarësisht lëvizjeve paralele apo ngritjes në detyrë:

| ____ | deri në 2 vjet

| ____ | 2 - 5 vjet

| ____ | 5 - 10 vjet

| ____ | mbi 10 vjet

5. Lutemi më thoni cilës grupmoshe i përkisni:

| ____ | 18-35 vjeç

| ____ | 35-45 vjeç

| ____ | 45-55 vjeç

| ____ | mbi 55 vjeç

6. Lutemi thoni gjininë tuaj:

| ____ | Mashkull | ____ | Femër

7. Lutemi identifikoni fushën e studimit/profesionit:

| ____ | Arsim/mësimdhënie

| ____ | Art

- | ____ | Shkenca sociale, gazetari, politikë
- | ____ | Ekonomi, biznes, ligje
- | ____ | Shkenca natyrore
- | ____ | Teknologji e informacionit
- | ____ | Inxhinieri/ Përpunim/Ndërtim
- | ____ | Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinar
- | ____ | Shkenca mjekësore
- | ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni

8. Lutemi thoni arsimin që keni kryer:

- | ____ | I mesëm
- | ____ | Universitar
- | ____ | Pasuniversitar, Master
- | ____ | Pasuniversitar, doktoratë
- | ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni:

II. Mbikëqyrja parlamentare

8. Duke iu referuar institucionit tuaj, lutemi raportoni se cili nga instrumentet e mëposhtme është ushtruar në mbikëqyrjen parlamentare. (Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë në përgjigjen tuaj.)

- | ____ | Interpelancë parlamentare;
- | ____ | Takim i komisionit parlamentar i mbledhur nga deputetët;
- | ____ | Takim i planifikuar i komisionit parlamentar, që i kushtohet raportimit vjetor të institucioneve të pavarura;
- | ____ | Takim i komisionit parlamentar i kërkuar nga vetë institucioni i pavarur;
- | ____ | Takim i komisionit parlamentar i kërkuar nga palë të tjera (specifikojeni);
- | ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni _____

10. Duke iu referuar aktiviteteve mbikëqyrëse parlamentare, lutemi raportoni, mesatarisht, sa shpesh kryhen në një vit ato? Lutemi referojuni aktiviteteve që raportuat në pyetjen 9 dhe referojini një mesatareje nga përvoja juaj.

- | ____ | deri në 2 herë në vit
- | ____ | 2 deri në 5 herë në vit
- | ____ | Më shumë se 5 herë në vit
- | ____ | Nuk më kujtohet
- | ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni _____

11. Lutemi raportoni sa shpesh janë diskutuar temat e mëposhtme në aktivitetet e mbikëqyrjes parlamentare të institucionit tuaj. Lutemi merrni parasysh të gjithë periudhën e punës në këtë institucion dhe raportoni një vlerë mesatare. Përdorni shkallën e mëposhtme të vlerësimit: 1- shumë shpesh, 2- shpesh, 3- ndonjëherë, 3- rrallë, 4- shumë rrallë, 5- kurrë:

- | ____ | Pranimi dhe diskutimi i raporteve vjetore të veprimtarisë së institucionit
- | ____ | Pranimi dhe diskutimi i rezultateve të punës së institucionit
- | ____ | Pranimi dhe prezantimi i rekomandimeve të institucioneve të pavarura për përmirësimin e funksionimit të ekzekutivit
- | ____ | Pranimi dhe prezantimi i planeve strategjike të institucionit
- | ____ | Pranimi dhe prezantimi i kandidaturave për drejtues të institucioneve të pavarura
- | ____ | Prezantimi i nismave ligjore
- | ____ | Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve për ekzekutivin
- | ____ | Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të nxjerra nga Parlamenti për institucionet e pavarura
- | ____ | Menaxhimi financiar i institucionit
- | ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni:

12. Lutemi jepni vlerësimin tuaj perceptues të komunikimit mes institucionit tuaj dhe Parlamentit/ komisionit parlamentar përgjegjës për mbikëqyrjen e institucionit tuaj:

- | ____ | Komunikimi është transparent dhe bashkëpunues
- | ____ | Komunikimi është formal por bashkëpunues dhe ndihmon në procesin e mbikëqyrjes
- | ____ | Komunikimit i mungon transparenca dhe bashkëpunimi, gjë që e bën të vështirë realizimin e mbikëqyrjes efektive
- | ____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni: _____

13. Bazuar në veprimtarinë mbikëqyrëse parlamentare, lutemi raportoni cili nga instrumentet e mëposhtëm, që mund të përdoret nga Parlamenti, është më efektiv për një proces mbikëqyrës: Përdorni shkallën e mëposhtme të vlerësimit: 1- shumë efektiv, 2- efektiv, 3- disi efektiv, 4- aspak efektiv, 5- nuk e di

- | ____ | raporte në interpelancë në Parlament
- | ____ | raportimi periodik, me shkrim, sipas kërkesave të ligjit
- | ____ | Takime me komisionin parlamentar të ndërmarrë nga vetë institucioni i pavarur
- | ____ | Sistem/platformë elektronike për monitorimin dhe raportimin

| _____ | Raporte të pavarura të autorizuara nga komisioni parlamentar për vlerësimin e aktivitetit të institucioneve

| _____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni. _____

14. Bazuar në përvojën e institucionit tuaj, si do ta vlerësonit ndikimin e mbikëqyrjes së Parlamentit në aspektet e mëposhtme të ngritjes dhe forcimit të institucionit tuaj. Për të shprehur shkallën e ndikimit Ju lutemi përdorni vlerësimin si më poshtë: 1- e lartë, 2- mesatare, 3- e ulët, 4- pa ndikim, 5- nuk e di.

| _____ | Forcimi i pavarësisë së institucionit

| _____ | Forcimi i kapacitetit të institucionit

| _____ | Forcimi i funksionit mbikëqyrës së institucioneve të pavarura

| _____ | Transparenca dhe përgjegjësia e institucionit janë përmirësuar

| _____ | Ndikimi i institucionit të pavarur në të mirën publike dhe politikëbërjen është forcuar

| _____ | Menaxhimi financiar i institucionit është përmirësuar

| _____ | Mbikëqyrja ka forcuar rolin e institucioneve të pavarura në luftën kundër korrupsionit

| _____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni _____

15. Bazuar në përvojën e institucionit tuaj, cili nga aspektet e mëposhtme përbën pengesën kryesorë në forcimin e rolit dhe ndikimit të institucionit tuaj si një autoritet i pavarur dhe mbikëqyrës i ekzekutivit? Zgjidhni të paktën tre faktorë, në varësi të ndikimit sipas perceptimit tuaj.

| _____ | Shkalla e ndikimit të politikave në veprimtarinë dhe vendimet e institucioneve të pavarura

| _____ | Kapacitetet teknike të institucioneve të pavarura

| _____ | Kapacitetet mbikëqyrëse të institucioneve të pavarura

| _____ | Shpesh është kuadri ligjor që nuk bën të mundur materializimin e fuqizimit dhe potencialit të institucioneve të pavarura

| _____ | Tjetër, lutemi përcaktojeni.

Shtojca 6. Pyetje për institucionet e pavarura

1. Duke iu referuar institucionit tuaj, lutemi na thoni sa herë keni marrë pjesë në një komision parlamentar për të raportuar për institucionin ku punoni? Cila ishte arsyeja/tema e raportimit në komision?
2. Si ishte marrëdhënia mes institucionit tuaj dhe institucionit të Parlamentit? Cili nga instrumentet e mbikëqyrjes parlamentare ka qenë më i zakonshmi në këtë marrëdhënie mes dy institucioneve? Instrumentet e mbikëqyrjes parlamentare përfshijnë raportimin në interpelancë në Parlament; Raportimi periodik, me shkrim, sipas kërkesave të ligjeve përkatëse; Takimet e komisionit parlamentar të nisur nga vetë institucioni i pavarur; sistemi/platforma e monitorimit /raportimit elektronik; Raporte të pavarura të kërkuara nga komisioni parlamentar për vlerësimin e veprimtarisë së institucioneve; komisionet parlamentare (p.sh. të përkohshme, hetimore).
3. Sipas gjykimit tuaj, sa ndikon mbikëqyrja parlamentare në performancën e institucionit ku punoni ju?
4. Si mund të garantojë institucioni i Parlamentit një monitorim efektiv të organeve ekzekutive të kryer nga institucioni ku punoni ju?
5. Sipas mendimit tuaj, si mund të përmirësohet/forcohet roli mbikëqyrës i institucionit tuaj për monitorimin e ekzekutivit?